



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Syllabusi i lëndës: Kontabiliteti i Kostos

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Kontabiliteti i Kostos
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Lënda Kontabiliteti i Kostos u ofron studentëve njohuri të specializuara dhe të avancuara mbi parimet dhe teknikat kryesore të kontabilitetit të kostos, duke theksuar përdorimin e tyre për mbështetjen e vendimmarrjes. Kursi fillon me prezantimin e natyrës dhe qëllimit të kontabilitetit të kostos, duke bërë një dallim të qartë ndërmjet tij dhe kontabilitetit financiar. Pjesa e dytë e programit trajton klasifikimin dhe sjelljen e kostos, duke përgatitur studentët për të kuptuar dinamikën e kostove në kontekste të ndryshme biznesi. Më tej, fokusi vendoset në teknikat dhe metodat e ndryshme të përlogaritjes së kostos që aplikohen në praktikën e biznesit. Programi përfshin gjithashtu përgatitjen e buxheteve dhe përdorimin e kostos standarde si mjete për planifikimin dhe kontrollin e kostove. Lënda përfundon me analizimin e rolit të kontabilitetit të menaxhimit në procesin e vendimmarrjes strategjike dhe operative. Kjo lëndë, e dizajnuar për nivelin Master, synon zhvillimin e aftësive analitike dhe menaxheriale, duke e bërë studentin të aftë të përdorë teknikat e kontabilitetit të kostos në vendimmarrje komplekse.
Qëllimet e lëndës:	Kjo lëndë ka për qëllim t'u ofrojë studentëve një kuptim të thelluar dhe të strukturuar të parimeve dhe teknikave të kontabilitetit të kostos, duke theksuar rëndësinë e saj në mbështetjen e vendimmarrjes strategjike dhe operacionale. Përmes kësaj lënde, studentët do të zhvillojnë aftësi analitike dhe praktike që lidhen me menaxhimin dhe kontrollin e kostove, duke u përgatitur për sfidat komplekse të mjedisit modern të biznesit. Qëllimet specifike të lëndës përfshijnë:

	• Pajisjen e studentëve me njohuri të avancuara mbi konceptet dhe teknikat kryesore të kontabilitetit të kostos. • Zhvillimin e aftësive për klasifikimin dhe analizimin e kostove në mënyrë kritike dhe efektive. • Theksimin e rolit të kontabilitetit të kostos në mbështetjen e vendimmarrjes së informuar dhe të qëndrueshme. • Përvetësimin e metodave për përgatitjen dhe analizimin e buxheteve dhe përdorimin e kostos standarde për planifikim dhe kontroll. • Zbatimin e teknikave të kontabilitetit të menaxhimit për analizën financiare dhe vendimmarrjen strategjike. • Dallimin e kontabilitetit të kostos nga kontabiliteti financiar dhe kuptimin e ndërveprimeve midis tyre. • Përgatitjen për zgjidhjen e problemeve reale në menaxhimin e kostove dhe performancës financiare në mjediset dinamike të biznesit. • Të menduarit kritik, kreativ dhe zgjedhjen e probleme komplekse në bizneset moderne krahasuar me trendet globale.
Kush Mund ta Studiojë këtë Lëndë?	Lënda "Kontabiliteti i Kostos" është ideale për studentët e nivelit Master për të dy specializimet "Menaxhim Biznesi" dhe "Banka dhe Financa" që kanë interes në menaxhimin financiar, analiza të thelluara të kostove dhe marrjen e vendimeve strategjike dhe operacionale. Ky kurs është i përshtatshëm për ata që synojnë të zhvillojnë aftësi të specializuara në menaxhimin dhe kontrollin e kostove në një mjedis biznesi dinamik dhe konkurrues. Nëse jeni: • Student të interesuar për financa dhe menaxhim, dhe dëshironi të thelloni njohuritë në analizën e kostove dhe të kuptoni se si këto njohuri mund të përmirësojnë vendimmarrjen strategjike të kompanive, kjo lëndë është për ju. • Menaxherë të ardhshëm ose profesionistë të financave, të cilët duan të zhvillojnë aftësi praktike dhe analitike për të përballuar sfidat komplekse të menaxhimit të kostove dhe të maksimizojnë performancën financiare të organizatave, kjo është mundësia juaj. • Individë që dëshirojnë të punojnë në kompani të mëdha, në sektorë të tillë si prodhimi, shërbimet, bankat, dhe organizatat e tjera që kërkojnë menaxhim të avancuar të kostove dhe optimizimin e burimeve, kjo lëndë do t'ju sigurojë njohuri dhe aftësi të nevojshme. Ky kurs do t'ju ofrojë mjetet dhe teknikat për të menaxhuar kostot në mënyrë efikase dhe do t'ju mundësojë të merrni

	vendime të informuara dhe strategjike, duke ndihmuar në përmirësimin e konkurrencës dhe rentabilitetit të organizatave në të cilat punoni. Përgatituni të bëheni profesionistë të menaxhimit të kostove që janë të kërkuara në mjedisin global të biznesit.
Rezultatet e prituratënixënies:	Njohuri (NJ): *NJ1: Të kuptojnë rëndësinë e kostove në afarizmin bashkëkohor, duke theksuar rolin e kontabilitetit të kostos në mbështetjen e vendimmarrjes strategjike dhe operacionale për korporatat prodhuese dhe shërbyese. * NJ2: Të analizojnë drejt llojet dhe klasifikimin e kostove, duke bërë dallimin midis kostove të drejtpërdrejta, të tërthorta, fikse dhe variable në një kontekst të avancuar të menaxhimit të kostove. * NJ3: Të demonstrojnë njohuri të avancuara mbi teknikat kryesore të kontabilitetit të kostos, përfshirë analizën e kostos standarde, koston sipas aktivitetit (ABC), dhe buxhetimin fleksibël. Aplikim-Kompetenca (A-K): **A-K1: Të jenë në gjendje të aplikojnë teknika të matematikës ekonomike dhe analiza statistikore për shqyrtimin dhe interpretimin e të dhënave mbi kostot në mënyrë të saktë dhe të informuar. **A-K2: Të aplikojnë drejt teknikat e kontabilitetit të kostos për përgatitjen e raporteve financiare dhe operacionale, të cilat ndihmojnë në kontrollin dhe planifikimin financiar të ndërmarrjeve. **A-K3: Të zbatojnë metoda të përparimit si analiza e diferencave, analizat e kufizimeve dhe të kontribuojnë në optimizimin e performancës financiare të organizatave. **A-K4: Të përdorin kontabilitetin e kostos për të zhvilluar dhe vlerësuar strategji të qëndrueshme të vendimmarrjes dhe të analizojnë ndikimin e vendimeve të tyre në suksesin e përgjithshëm të organizatës. **A-K5: Të interpretojnë dhe të përgatitin buxhete të detajuara, duke përfshirë buxhetet operacionale, kapitale dhe buxhetet e përgjithshme për planifikim dhe kontroll financiar. Aftësi (A): ***A1: Të demonstrojnë aftësi për të prezantuar dhe shpjeguar koncepte komplekse të kontabilitetit të kostos

	në mënyrë të qartë, argumentuese dhe bindëse për audiencat profesionale dhe akademike. ***A2: Të zhvillojnë aftësi për të bashkëpunuar efektivisht në ekipe, duke kontribuar në projekte që synojnë të analizojnë dhe përmirësojnë strukturat e kostove në organizata. ***A3: Të përdorin mjetet dhe teknologjitë bashkëkohore të informacionit për menaxhimin e të dhënave të kostos, përfshirë softuerët e specializuar për kontabilitet dhe menaxhim financiar. ***A4: Të zbatojnë teknikat e kontabilitetit të kostos për të adresuar problemet reale në menaxhimin e kostove dhe performancës financiare, duke marrë në konsideratë trendet globale dhe kërkesat e mjedisit modern të biznesit. ***A5: Të kontribuojnë në mënyrë kreative dhe të menduar në zgjidhjen e problemeve komplekse që lidhen me optimizimin e kostove dhe përmirësimin e efikasitetit në organizata, duke ndjekur praktikat më të mira ndërkombëtare. <i>Sqarim:</i> Rezultatet e pritura të syllabusit janë të përpiluara konform rezultateve të pritura të programit, në përputhje me standardet e AKA-së. *Njohuri (Nj) **Aplikim-Kompetenca (A-K) ***Aftësi (A)
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	2	5	10
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	10	1	10

Koha e studimit vetanak të studentit	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	10	1	10
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Totali			150

Sqarim: 1 orë = 25 ECTS kredi.

Përshtatja e ECTS me orët totale: 150 orë ÷ 25 = 6 ECTS kredi.

Metodologjia e mësimdhënies:

Në tre orë ligjerata dhe në dy orë ushtrime do të shtjellohet materiali mesimor, do të zgjidhen detyra në tabele, do të përdoren raste studimore nga praktika e biznesve në Kosovë dhe më gjërë, do të merren për bazë hulumtime shkencore të profesorit të lëndës si dhe hulumtueseve tjerë të kësaj fushe, do të organizohet diskutim grupor, mendimi kritik, mendim kreativ, zgjedhja e problemeve, dhe teste të vetëvlerësimit përmes programeve teknologjike që nderlidhen më lëndën. Në ushtrime, krahas zgjedhjeve të detyrave nga lënda mësimore, do të zhvillohen diskutime për problemet e ndryshme rreth kontabilitetit si: rajonale, vendore, si dhe menyra e zgjedhjes se këtyre problemeve. Pra, studentet inkurajohen që të përcjellin rrjedhat e kontabilitetit në bizneset në vend dhe në gjithë botën. Pastaj, pas çdo ore mësimore do jepen detyra për zgjidhje, të cilat diskutohen në javën në vijim të orës së ligjeratës apo ushtrimeve. Mësimdhënia do të përqendrohet në pjesëmarrjen aktive të studentëve në procesin e mësimin.

Mbajtja e ligjeratave dhe ushtrimeve do të realizohet në këte formë:

- Prezantimi i temës në PPT dhe zgjidhja e detyrave në tabele,
- Raste studimore të kontabilitetit të kostos për çdo orë të ushtrimeve nga ligjerata e spjeguar,
- Përsëritja e temës paraprake nga studentët,
- Aplikimi i programeve të kontabilitetit të kostos përmes softwerit,
- Analiza dhe diskutime nga ekspertë të ftuar të lëmisë së kontabilitetit të kostos qoftë vendor apo ndërkombëtar
- Raporte financiare, raste studimore, hulumtime, ide dhe te ftuar nga industria.

Metodat e vlerësimit:

- *Projekt shkencor:* 20%
- *Ushtrime:* 20%
- *Interaktivitet, pjesëmarrje dhe obligime tjera:* 10%
- *Provimi përfundimtar:* 50%
- **Total** 100%

Vlerësimi në % dhe nota përfundimtare

91-100 = 10 (dhjetë)

81-90 = 9 (nëntë)

71-80 = 8 (tetë)

	61-70 = 7 (shtatë) 51-60 = 6 (gjashtë) 0-50 = 5 (pesë)
Literatura	
Literatura bazë:	- Skender Ahmeti "Kontabiliteti i koston" Prishtinë, 2018. - Kontabiliteti i Menaxhmentit dhe i Koston (P2): Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar të ShKCAK
Literatura shtesë:	- Hansen & Mowen: "Menaxhimi i Koston: Kontabilitet dhe Kontroll" ASu-Up, 2009. - Skender Ahmeti: "Kontabiliteti i menaxhmentit" Prishtinë, 2013. - Shefekt Jakupi, Bedri Statovci "Kontabiliteti i Menaxhmentit dhe Koston", Prishtinë, 2021 - Literature ne gjuhe angleze: LIBRA - Literaturë në gjuhë angleze (hulumtime, raporte, analiza, pasqyra kontabel, diskutimet etj.) - Hulumtimet shkencore të profesorit të lëndës: https://www.researchgate.net/ https://scholar.google.com/ https://harvard.edu https://www.freebookcentre.net/business-books-download/Cost-Accounting-Study-Material.html
Plani i dizajnuar i mësimit: Llogaritë e profesorit për të mbështetur studentët: https://harvard.edu/profile/lulajenkeleda , Pasword:.... https://classroom.google.com/u/2/lulajenkeleda , Pasword:..... https://zipbooks.com/ , softwares.	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Kontabiliteti i koston në mjedisin biznesor Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e dytë:	Rrjedha e kostove organizative Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e tretë:	Përcaktimi i sjelljes së kostove Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e katërt:	Kontrolli i kostove të drejtëpërdrejta të produktit Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e pestë:	Akumulimi dhe alokimi i kostove të tërthorta Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e gjashtë:	Kalkulimi i koston për porosinë Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e shtatë:	Kalkulimi i koston së proceseve Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e tetë:	Kalkulimi i kostove sipas aktiviteteve dhe analiza e profitabilitetit Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e nëntë:	Alokimi i kostove të departamenteve mbështetëse Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e dhjetë:	Alokimi i kostove: produktet e lidhura dhe nënproduktet Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi

Java e njëmbëdhjetë:	Njësitë më defekte, njësitë e ripërpunuara dhe skrap Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e dymbëdhjetë:	Buxhetimi Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e trembëdhjetë:	Llogaritja e kostove marxhinale dhe përvetësimi i tyre Llogaritja e kostove të procesit të prodhimit Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e katëmbëdhjetë:	Analiza kosto-vëllim-fitim Programimi linear Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e pesëmbëdhjetë:	Mbrojtje e projekteve hulumtuese dhe përgatitje për provimin final Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Për çdo temë mësimore ,studentët do të pajisen më materiale të nevojshme në gjuhë shqipe ,
- Në fund të çdo ore mësimore grupet e caktuara të studentëve do të angazhohen më detyrë apo rast studimi lidhur më temën e ligjërvara ,më çrast rezultatet e arritura nga kjo detyrë ,grupet e studentëve duhet të prezantojnë dhe ti diskutojnë ato në orën e ushtrimeve ,
- Pjesëmarrja në ligjerata dhe ushtrime është e obliguar ,
- Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjeratave dhe ushtrimeve . Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve ,
- Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit ,por vlerësimi i tyre do të jetë dhe përqindja e provimit përfundimtar,
- Studentët inkurajohen të bëjnë vizita nëpër ndermarrje dhe të shofin aplikimin e kontabilitetit në praktikë.

Vërejtje për studentin:

- Para se gjithash studenti duhet të jetë i ndergjegjshëm dhe të respektojë Insitucionin, rregullat shkollore ,çdo vendim dhe çdo rregullore lidhur më çështjet mësimore,
- Duhet të respektojë orarin e ligjeratave ,ushtrimeve dhe të jetë i vemëndshëm në orën mësimore,
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID-kartelës në teste dhe në provim,
- Gjatë hartimit të punimit seminarik ,studenti duhet tu përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimi,
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj studentët duhet të përqendrohen vetëm në njohuritë personale ,shkelja eventuale e kety re rregullave ndeshkohet konform vendimeve, rregulloreve të parapara më statut dhe ligj .